



UNIVERSITETI
I SHKENCAVE TË APLIKUARA
FERIZAJ

Rektori
Prof. Dr. Agron Bajraktari

Nr. Prot.: 250/22; Datë: 03.02.2022

Në bazë të nenit 47, paragrafi 1.1 si dhe nenit 155, paragrafi 1 dhe paragrafi 10 të Statutit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF) Senati i UShAF në mbledhjen e mbajtur më 03.02.2022, merr

V E N D I M

I.

Miratohet Rregullorja për procedurat e avancimit ose rizgjedhjes së personelit të rregullt akademik në UShAF.

II.

Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit të tij.

A r s y e t i m

Senati i UShAF për qëllim të plotësimit të infrastrukturës ligjore në pajtim me Statutin e UShAF pas elaborimit të draft rregullore në fjalë, në mënyrë unanime vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

1. Senatit të UShAF;
2. Arkivit të UShAF;

Rektori
Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

Kryesuesi i Senatit
Prof. Dr. Agron Bajraktari

Nr. prot.: 250/22; Datë: 03.02.2022

Mbështetur në kompetencat e përcaktuara me nenin 155, paragrafet 1 dhe 10 të Statutit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2018 për parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension, Senati i UShAF në mbledhjen e datës 03.02.2022, miratoi:

R R E G U L L O R E

PËR PROCEDURAT E AVANCIMIT OSE RIZGJEDHJES SË PERSONELIT TË RREGULLT AKADEMIK NË UNIVERSITETIN E SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ

Neni 1 **Qëllimi**

1. Kjo Rregullore ka për qëllim rregullimin dhe përcaktimin e procedurave për avancim ose rizgjedhje të personelit të rregullt akademik, në thirrjen profesor i rregullt, profesor i asocuar, profesor asistent, ligjërues dhe lektor në UShAF.
2. Sipas kësaj Rregulloreje, personeli akademik në marrëdhënie të rregullt pune në UShAF, mund të aplikojë për avancim ose rizgjedhje sipas thirrjeve akademike të përshkruara në paragrafin 1 të këtij neni.
3. Çështjet, që nuk janë rregulluar në mënyrë shprehimore në Statutin e UShAF, lidhur me procedurat vlerësuese për avancimin dhe rizgjedhjen e personelit akademik, rregullohen në dispozitat vijuese të kësaj Rregulloreje.

Neni 2

Kriteret për avancimin dhe rizgjedhjen në thirrje akademike

1. Procedura vlerësuese për avancim ose rizgjedhje në thirrje akademike mbështetet në kriteret që dalin nga aktivitetet në vijim:
 - Aktiviteti arsimor - Shtojca I;
 - Aktiviteti hulumtues, shkencor dhe profesional - Shtojca II;
 - Aktiviteti shërbyes - Shtojca III.
2. Avancimi ose rizgjedhja e personelit akademik bëhet pasi të shqyrtohet dokumentacioni i parashtruesit të kërkesës për avancim ose rizgjedhje nga komisioni vlerësues, i formuar nga Këshilli Mësimor/Shkencor. Komisioni vlerësues bën vlerësimin e parashtruesit të



kërkesës për avancim dhe rizgjedhje, me ç'rast vlerëson se ka përmbushur ose jo kushtet për avancim ose rizgjedhje.

3. Komisioni vlerësues përgatitë raport me shkrim në afat sa më të shkurtë dhe njofton organin, i cili e ka formuar.
4. Askush nuk mund të jetë anëtar i komisionit vlerësues, nëse është bashkëshort, partner ose anëtar i familjes së ngushtë të parashtruesit të kërkesës për avancim ose rizgjedhje.
5. Për avancimin ose rizgjedhjen e parashtruesit të kërkesës në thirrjen përkatëse, kërkohet plotësimi i minimumit të kriterëve të parapara në Statutin e UShAF, përkatësisht në shtojcat përkatëse të kësaj Rregulloreje.
6. Shtojcat I, II, III janë pjesë përbërëse të kësaj Rregulloreje.

Neni 3

Avancimi në thirrjen e Profesorit të rregullt

1. Personeli akademik, i cili ka titullin akademik "Profesor i asocuar", parashtron kërkesën për avancim, përkatësisht për fitimin e titullit akademik "Profesor doktor", të paktën katër (4) vite pas fitimit të titullit akademik "Profesor i asocuar".
2. Në pajtim me nenin 157 të Statutit të UShAF, parashtruesit të kërkesës, i cili aplikon për avancim për titullin e profesorit të rregullt duhet të ketë këto kualifikime:
 - 2.1. Të ketë gradën e doktorit të shkencës;
 - 2.2. Përfshihet nga paragrafi 2.1 i këtij neni, në Fakultetin e Arteve të Aplikuara, për avancim në thirrjen profesor i rregullt, në mungesë të doktoratës, duhet të jetë grada Mr/MA i Arteve.
 - 2.3. Të tregojë nivel të lartë dhe kompetencë akademike e përvojë shkencore për lëndën që dëshmohet, me:
 - 2.3.1. Së paku dy (2) monografi, (doktorata e publikuar njihet si një monografi);
 - 2.3.2. Së paku një (1) tekst mësimor si autorë i parë;
 - 2.3.3. Së paku pesë (5) punime shkencore të publikuara në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, si autor i parë, dhe të indeksuara në platformat e identifikuar me UA 01/18 të MASHT¹, me Impakt Faktor IF>0.1 në kohën e publikimit të punimit, nga thirrja e fundit akademike, nga fusha përkatëse e studimit;
 - 2.3.4. Përfshihet nga paragrafi 2.3.3 i këtij neni, në Fakultetin e Arteve të Aplikuara, për lëndët teorike, duhet së paku pesë (5) punime shkencore të publikuara në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, si autor i parë,

¹ Udhëzim Administrativ (MASHT) Nr. 01/2018 Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension



dhe të indeksuara në platformat e identifikuara me UA 01/18 të MASHT, me Impakt Faktor $IF > 0.1$, në kohën e publikimit të punimit, nga thirrja e fundit akademike, nga fusha përkatëse e studimit. Ndërsa, për lëndët artistike, së paku pesë (5) aktivitete kryesore personale artistike ndërkombëtare, nga thirrja e fundit akademike. Në rastet e lëndëve të kombinuara, teorike dhe artistike, së paku pesë (5) punime shkencore nga fusha përkatëse e studimit apo aktivitete artistike sipas përshkrimit më lartë, ku së paku një prej tyre të jetë punim shkencor dhe së paku një të jetë aktivitet personal artistik;

2.3.5. Pjesëmarrje aktive në së paku pesë (5) konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare (të dëshmuara në njërën formë: me proceedings book, botim të abstrakteve apo agjendën e konferencës si referues), nga thirrja e fundit akademike, nga fusha përkatëse e studimit;

2.3.6. Përfshirja nga paragrafi 2.3.5 i këtij neni, në Fakultetin e Arteve të Aplikuara, kërkohet pjesëmarrje në së paku tri (3) ekspozita në galeri institucionale, gara, panairë të produkteve dhe festivale të karakterit ndërkombëtar, me punim individual apo edhe grupor;

2.3.7. Pjesëmarrje në dy projekte ndërkombëtare.

2.4. Për lëndët e arteve figurative duhet të ketë krijime ose punime të njohura artistike, të ketë pasur prezantime publike dhe të ketë kontribuar në zhvillimin e kulturës dhe të artit;

2.5. Të ketë treguar aftësi të lartë arsimore dhe pedagogjike përmes praktikës;

2.6. Të ketë treguar aftësi për udhëheqje akademike;

2.7. Të ketë udhëhequr të paktën tetë (8) studentë në studimet master në tema të diplomave (përfshirja Fakulteti i Arteve të Aplikuara, të ketë udhëhequr të paktën tre (3) studentë);

2.8. Të ketë qenë së paku katër (4) vite Prof. Asoc. Dr.

Neni 4

Avancimi në thirrjen e Profesorit të asocuar

1. Personeli akademik, i cili ka titullin akademik "Profesor asistent", parashtron kërkesën për avancim, përkatësisht për fitimin e titullit akademik "Profesor i asocuar", të paktën katër (4) vite pas fitimit të titullit akademik "Profesor asistent".
2. Në pajtim me nenin 158 të Statutit të UShAF, për titullin e Profesorit të asocuar, parashtruesi i kërkesës për avancim duhet të ketë këto kualifikime:

2.1. Të ketë gradën e doktorit të shkencës;

2.2. Përfshirja nga paragrafi 2.1 i këtij neni, në Fakultetin e Arteve të Aplikuara, për thirrjen Profesor i asocuar, në mungesë të doktoratës, kërkohet grada MSc/MA i Arteve;

2.3. Të tregojë nivel të lartë dhe kompetencë akademike e përvojë shkencore (artistike për Fakultetin e Arteve të Aplikuara) për lëndën që dëshmohet me:

fb.

- 2.3.1. Së paku një (1) monografi, (doktorata e publikuar njihet si monografi);
- 2.3.2. Së paku tri (3) punime shkencore të publikuara në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, si autor i parë, dhe të indeksuara në platformat e identifikuara me UA 01/18 të MASHT, me Impakt Faktor $IF > 0.1$ në kohën e publikimit të punimit, nga thirrja e fundit akademike, nga fusha përkatëse e studimit;
- 2.3.3. Përfshihet nga paragrafi 2.3.2 i këtij neni, në Fakultetin e Arteve të Aplikuara për lëndët teorike, kërkohen së paku tri (3) punime shkencore të publikuara në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, si autor i parë, dhe të indeksuara në platformat e identifikuara me UA 01/18 të MASHT, me Impakt Faktor $IF > 0.1$ në kohën e publikimit të punimit. Ndërsa, për lëndët artistike së paku tri (3) aktivitete të realizuara personale artistike ndërkombëtare, nga thirrja e fundit akademike. Në rastet e lëndëve të kombinuara, teorike dhe artistike, së paku tri (3) punime shkencore, nga fusha përkatëse apo aktivitete artistike, sipas përshkrimit më lartë, ku së paku një prej tyre të jetë punim shkencor dhe së paku një të jetë aktivitet personal artistik;
- 2.3.4. Pjesëmarrje aktive në së paku tri (3) konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare (të dëshmuara në njërin formë: me proceedings book, botim të abstrakteve apo agjendën e konferencës si referues), nga thirrja e fundit akademike, nga fusha përkatëse e studimit;
- 2.3.5. Përfshihet nga paragrafi 2.3.4 i këtij neni, në Fakultetin e Arteve të Aplikuara, kërkohet pjesëmarrje në së paku dy (2) ekspozita në galeri institucionale, gara, panairë të produkteve dhe festivale të karakterit ndërkombëtar, me punim individual apo edhe grupor;
- 2.4 Të tregojë aftësi për mësimdhënie;
- 2.5 Të dëshmojë punë, dije dhe mjeshtri në lëndën e fushës përkatëse.
- 2.6 Të ketë qenë së paku katër (4) vite Prof. As. Dr.

Neni 5

Avancimi në thirrjen e Profesorit asistent

1. Personeli akademik, i cili ka titullin akademik "Ligjërues" ose "Lektor", parashtron kërkesën për avancim, përkatësisht për fitimin e titullit akademik "Profesor asistent", të paktën tri (3) vite pas fitimit të titullit akademik "Ligjërues" ose "Lektor".
2. Në pajtim me nenin 159 të Statutit të UShAF, për titullin e Profesorit asistent, parashtruesi i kërkesës për avancim duhet të ketë këto kualifikime:

2.1. Të ketë gradën e doktorit të shkencës;

2.2. Përfshihet nga paragrafi 2.1 i këtij neni, në Fakultetin e Arteve të Aplikuara, për fitimin e titullit Profesor asistent, në mungesë të doktoratës, kërkohet grada MSc/MA i Arteve;



- 2.3. Të tregojë nivel të lartë dhe kompetencë akademike e përvojë shkencore për lëndën që dëshmohet me:
- 2.3.1. Së paku një (1) monografi, (doktorata e publikuar njihet si monografi)
 - 2.3.2. Së paku një (1) punim shkencor i publikuar në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, si autor i parë, dhe të indeksuara në platformat e identifikuar me UA 01/18 të MASHT, me Impakt Faktor $IF > 0.1$, në kohën e publikimit të punimit, nga fusha përkatëse e studimit;
 - 2.3.3. Përfundimisht nga paragrafi 2.3.2 i këtij neni, në Fakultetin e Arteve të Aplikuara për lëndët teorike, kërkohen së paku një (1) punim shkencor të publikuar në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, si autor i parë, dhe të indeksuara në platformat e identifikuar me UA 01/18 të MASHT, me Impakt Faktor $IF > 0.1$ në kohën e publikimit të punimit. Ndërsa, për lëndët artistike, kërkohen së paku një (1) aktivitet të realizuar personale artistike ndërkombëtare, nga thirrja e fundit akademike. Në rastet e lëndëve të kombinuara, teorike dhe artistike, një punim shkencor nga fusha përkatëse ose një aktivitet personal artistik, sipas përshkrimit më lartë.
 - 2.3.4. Pjesëmarrje aktive në së paku një (1) konferencë kombëtare dhe ndërkombëtare (të dëshmjuara në njërën formë: me proceedings book, botim të abstrakteve apo agjendën e konferencës si referues);
 - 2.3.5. Përfundimisht nga paragrafi 2.3.4 i këtij neni, në Fakultetin e Arteve të Aplikuara, kërkohet pjesëmarrje në së paku një (1) ekspozitë në galeri institucionale, gara, panairë të produkteve dhe festivale të karakterit ndërkombëtar, me punim individual apo edhe grupor;
- 2.4. Të tregojë aftësi për mësimdhënie;
- 2.5. Të dëshmojë punë, dije dhe mjeshtri në lëndën e fushës përkatëse;
- 2.6. Të ketë krijuar punime të vërteta artistike ose të ketë pasur prezantime publike, kur është rasti për Fakultetin e Arteve të Aplikuara.

Neni 6

Rizgjedhja në thirrjen e Ligjëruesit

1. Në pajtim me nenin 160 të Statutit të UShAF, për titullin e Ligjëruesit, kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:
 - 1.1. Të ketë të përfunduar së paku nivelin e dytë të studimeve (MA, MSc apo Magjistraturë);
 - 1.2. Të tregojë nivel të lartë dhe kompetencë akademike e përvojë shkencore për lëndën që dëshmohet me:
 - 1.2.1. Së paku një punim shkencor të publikuar në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, dhe të indeksuara në platformat e identifikuar me UA 01/18 të MASHT, me Impakt Faktor $IF > 0.1$, si autor i parë, nga fusha përkatëse e studimit;

sp.

1.2.2. Përfundimisht nga paragrafi 1.2.1 i këtij neni, në Fakultetin e Arteve të Aplikuara për lëndët teorike, kërkohet së paku një punim shkencor i publikuar në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, si autor i parë, dhe të indeksuara në platformat e identifikuara me UA 01/18 të MASHT, me Impakt Faktor $IF > 0.1$ në kohën e publikimit të punimit, si autor i parë. Ndërsa, për lëndët artistike së paku një aktivitet i realizuar personal artistik ndërkombëtar, si autor i parë ose i vetëm. Në rastet e lëndëve të kombinuara, teorike dhe artistike, një punim shkencor nga fusha përkatëse ose një aktivitet personal artistik, sipas përkrahimit më lartë.

1.2.3. Pjesëmarrje në së paku një konferencë ndërkombëtare, si prezantues oral i punimit, si autor i parë, nga fusha përkatëse e studimit;

1.2.4. Përfundimisht nga paragrafi 1.2.3 i këtij neni, në Fakultetin e Arteve të Aplikuara, kërkohet pjesëmarrje në së paku një (1) ekspozitë në galeri institucionale, garë, panair të produkteve dhe festival të karakterit ndërkombëtar, me punim individual apo edhe grupor;

1.3. Të tregojë aftësi për mësimdhënie;

1.4. Të dëshmojë aftësi në punë me projekte shkencore/profesionale.

Neni 7

Rizgjedhja në thirrjen e Lektorit

1. Në pajtim me nenin 161 të Statutit, për titullin e Lektorit të gjuhëve të huaja, kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:

1.1. Të ketë të përfunduar me sukses studimet master në gjuhën e zgjedhur;

1.2. Të ketë aftësi të shkëlqyeshme të gjuhës së zgjedhur;

1.3. Të tregojë aftësi për mësimdhënie;

1.4. Të dëshmojë aftësi në punë me projekte shkencore/profesionale.

Neni 8

Përkufizimet lidhur me nenet 3-7

1. Monografi konsiderohet edhe punimi i doktoratës në formë monografie, i publikuar si botim i veçantë, në Kosovë ose vende të tjera, me ISBN dhe i kataloguar.

2. Tekst mësimor konsiderohet libri universitar, i publikuar nga shtëpitë botuese të universiteteve publike të Kosovës, në gjuhën shqipe ose në gjuhë të huaja, si autor i parë për nevoja të studentëve në fushën përkatëse. Libri duhet të jetë i botuar në formë të shtypur apo elektronike, të jetë i shqyrtuar nga së paku dy (2) recensentë, së paku me titull Dr. sc., në fushën e njëjtë ose të afërt dhe të ketë ISBN. Pranohet edhe teksti për përdorim të brendshëm me ligjërata/ushtime, i botuar në formë të shtypur ose elektronike, i shqyrtuar nga së paku dy (2) recensentë, së paku me titull Dr. sc., në fushën e njëjtë ose të afërt, konform Rregullores për botime të USHAF.

S.B.

3. Punimi duhet të botohet në revistat shkencore ndërkombëtare të indeksuara në ndonjërin prej këtyre dy databazave:
 2.7 Web of Science: <http://mjl.clarivate.com> (në ndonjërin prej koleksioneve bërthamë: SCIE; SSCI; AHCI)
 2.8 Scopus (Elsevier): <https://www.scopus.com>
4. Punimet e publikuara sipas kërkesave të kësaj Rregulloreje nuk merren parasysh nëse në fazat e vlerësimit, deri në momentin e marrjes së vendimit përfundimtar konstatohet që revistat përkatëse janë të përfshira në lista të revistave ose botuesve të dyshimtë. Revista të dyshimta konsiderohen revistat, të cilat nuk e aplikojnë procesin e vërtetë të recensionit profesional (peer review), nuk kanë ISSN të vërtetë, nuk kanë uebfaqe ose kanë një të tillë të dyshimtë, personi juridik apo fizik botues nuk ka adresë ose numër kontakti, deklaron adresë ose numër kontakti fiktiv, paraqet indeksim ndërkombëtar të rremë, deklaron faktor ndikimi të rremë, botuesi i tyre është i dyshimtë në kuptimin e mënyrës së menaxhimit dhe paletës së revistave që publikon. Senati rezervon të drejtën që në çdo moment ta tërheqë njohjen e publikimit në revistat e dyshimta ose botuesit e dyshimtë, por para vlerësimit përfundimtar të kandidatit.
5. Aftësia për mësimdhënie dhe ajo pedagogjike dëshmohen nëpërmjet një (1) certificate për metodologji të mësimdhënies, të fituara nga qendra përkatëse apo nga institucione të specializuara vendore dhe ndërkombëtare. Aftësia për mësimdhënie dhe ajo pedagogjike dëshmohen poashtu përmes vlerësimeve që bëhen nga studentët, menaxhmenti dhe kolegët.
6. Përvojë afatgjatë në projekte ndërkombëtare, e cila nënkupton pjesëmarrjen në një projekt, program ndërkombëtar të kapacitetit hulumtues, ndërtim të kapaciteteve dhe mobiliteteve në kuadër të programit ERASMUS+, apo projekteve të tjera, të financuara nga donatorët e huaj, përmes të cilave arrihen rezultate me rëndësi për universitetin, industrinë dhe komunitetin.
7. Aftësi për udhëheqje akademike nënkupton aftësitë dhe kontributin e shprehur përmes angazhimit, në të paktën njërin nga këto: si anëtar i komisioneve vlerësuese për zgjedhjen dhe avancimin e stafit akademik, komisioneve për mbrojtje të temave master dhe doktoratë, pjesëmarrjes si recensent i monografive dhe teksteve mësimore, pjesëmarrjes në këshillin shkencor të konferencave vendore apo ndërkombëtare.
8. Të gjitha afatet në këtë Rregullore, nënkuptojnë ditët kalendarike, përveç nëse specifikohet ndryshe në këtë Rregullore.

Neni 9

Kohëzgjatja e avancimit dhe kufizimet për avancim

1. Të gjitha avancimet për tituj, si dhe kohëzgjatja e punësimit bëhen në përputhje me dispozitat përkatëse të Statutit të UShAF.
2. Avancimi nuk është proces automatik, por është i bazuar dhe meritore për të gjitha pozitave, sipas dispozitave të Statutit të UShAF.

3. Titujt e parë që fitohen në UShAF janë: profesor asistent, lektor dhe ligjërues, ndërsa gjatë procesit të avancimit nuk lejohet tejkalimi i thirrjeve të parapara me Statut të UShAF.
4. Personeli akademik, i cili nuk është avancuar (nuk ka plotësuar kriteret për avancim) në aplikimin përkatës, mbetet në thirrjen paraprake, pra rizgjedhet në pozitën e njejtë. Përfshirë personeli akademik, i cili nuk plotëson kushtet sipas nenit 8, pika 5 e kësaj Rregulloreje.
5. Personeli akademik, i cili nuk është avancuar mund të aplikojë për avancim pas dy (2) vitesh, nga data e vendimit për rizgjedhje.
6. Përfshirë nga pika 5 e këtij neni është personeli akademik me thirrjen ligjërues dhe lektor, të cilët janë rizgjedhur por të cilët më pas kanë kryer doktoraturën.
7. Procedurat dhe kushtet për revokimin e titujve, suspendimin apo ndërprerjen e marrëdhënieve të punës të stafit përcaktohen me rregullore të posaçme, të nxjerra nga Këshilli Drejtues.

Neni 10

Procedurat për avancim ose rizgjedhje

1. Parashtruesi i kërkesës, i cili plotëson kushtet për t'u avancuar apo rizgjedhur, aplikon për avancim ose rizgjedhje në thirrje mësimore, pas skadimit të thirrjes ekzistuese.
2. Kërkesa për avancim ose rizgjedhje i drejtohet Këshillit Mësimor/Shkencor të UShAF.
3. Parashtruesi i kërkesës për avancim ose rizgjedhje duhet të dorëzojë dokumentet e nevojshme në formë të shtypur dhe elektronike.
4. Dokumentacioni i shtypur duhet të dorëzohet në Këshillim Mësimor/Shkencor, kurse versionin elektronik në adresën zyrtare të UShAF (info@ushaf.net).

Neni 11

Ndaletat për avancim ose rizgjedhje

1. Personeli akademik, i cili ka marrëdhënie të rregullt të punës në UShAF mund t'i nënshtrohet procesit për rizgjedhje apo avancim.
2. Personeli akademik, i cili ka një funksion tjetër jashtë UShAF, e të cilit i është shkëputur kontrata e rregullt e punës dhe që kompensohet vetëm për orët e realizuara në UShAF nuk ka të drejtë të rizgjidhet dhe as të avancohet gjatë periudhës së ushtrimit të funksionit jashtë UShAF.
3. Personeli akademik, i cili është në pushim pa pagesë dhe nuk është duke punuar aktualisht në UShAF, nuk i llogaritet kjo periudhë, dhe nuk ka të drejtë të avancohet ose të rizgjedhet gjatë kësaj periudhe.
4. Personeli akademik, i cili mban funksione publike dhe që ka pezulluar marrëdhënien e punës në UShAF, gjatë kësaj periudhe të pezullimit nuk mund t'i nënshtrohet procesit të rizgjedhjes apo të avancimit.



5. Procesit për avancim ose rizgjedhje nuk mund t'i nënshtrohet as personeli akademik, ndaj të cilit ka masë disiplinore të plotfuqishme që në mënyrë shprehimore ndalon avancimin ose rizgjedhjen akademike.
6. Procesit të avancimit ose rizgjedhjes nuk mund t'i nënshtrohet as personeli akademik, të cilit i kanë mbetur më pak se 12 muaj deri në pension, përveç në rastet kur rrezikohet akreditimi i programit përkatës.

Neni 12

Komisionet vlerësuese

1. Këshilli Mësimor/Shkencor, është i obliguar që për çdo kërkesë për avancim ose rizgjedhje t'a caktojë Komisionin vlerësues.
2. Brenda dhjetë (10) ditëve pas parashtrimit të kërkesës për avancim ose rizgjedhje, Prorektori për Mësim, Shkencë dhe Çështje Studentore, thërret mbledhjen e Këshillit Mësimor/Shkencor, në të cilën merret vendimi për themelimin e Komisionit vlerësues.
3. Komisionet vlerësuese janë organe me kredibilitet të lartë profesional, akademik dhe etik.
4. Komisioni vlerësues përbëhet nga:
 - 4.1. Një (1) anëtar, përfaqësues i rektoratit, i cili delegohet nga Rektori;
 - 4.2. Një (1) anëtar, përfaqësues i dekanatit të fakultetit përkatës, i cili delegohet nga Dekani;
 - 4.3. Tre (3) anëtarë të lëmisë përkatëse, për të cilën parashtrohet kërkesa për avancim, të cilët emërohen nga Këshilli Mësimor/Shkencor.
5. Anëtar të Komisionit vlerësues të emëruar nga Këshilli Mësimor/Shkencor mund të jenë edhe strukturat udhëheqëse të Universitetit.
6. Nëse në UShAF nuk ka personel akademik të lëmisë përkatëse, atëherë kërkohet që ata të plotësohen nga universitetet publike të Kosovës.
7. Kryesues i Komisionit është anëtari i deleguar nga Rektori.
8. Vlerësimi i të gjithë anëtarëve të Komisionit Recenzues është i barabartë (nga njëzet (20) pikë) të vlerësimit të përgjithshëm prej njëqind (100) pikëve.
9. Në raste të arsyeve të bazuara, anëtari i Komisionit, në afat prej pesë (5) ditëve pas formimit të Komisionit vlerësues, mund të deklarojë me shkrim tërheqjen e tij nga Komisioni. Në këtë rast, anëtari zëvendësohet brenda shtatë (7) ditëve nga organi i cili e ka deleguar atë sipas paragrafit 4 të këtij neni.
10. Administrata e UShAF, duhet t'ia ofrojë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm Komisionit vlerësues.



11. Kryetari i Komisionit vlerësues është i obliguar të mbledhë anëtarët e Komisionit për të:

11.1. Shqyrtuar kërkesat e parashtruara për avancim dhe rizgjedhje;

11.1. Hartuar raportin e vlerësimit për parashtruesin e kërkesës për avancim ose rizgjedhje.

12. Vlerësimi për avancim ose rizgjedhje akademike bëhet në këto fusha:

12.1. Publikimet në revistat shkencore, bazuar në vlerësimin sipas Shtojcës II të kësaj Rregulloreje.

12.2. Përvoja në mësimdhënie akademike.

12.3. Aktivitetet tjera relevante duke përfshirë:

- Publikimet tjera shkencore në revistat vendore dhe ndërkombëtare, të cilat nuk janë të indeksuara sipas paragrafit A2 të Shtojcës II;
- Mentorimet e temave të diplomës bachelor;
- Mentorimet e temave të diplomës master;
- Pjesëmarrje në konferenca shkencore;
- Pjesëmarrje në trajnime profesionale;
- Përvoja e punës profesionale (jo akademike);
- Botimet e teksteve universitare;
- Anëtar i organizatave profesionale;
- Anëtar i komisioneve redaktuese në revista shkencore, dhe recensent në botime universitare, etj.

13. Komisioni vlerësues është i obliguar që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e formimit nga Këshilli Mësimor/Shkencor, të dorëzojë raportin e vlerësimit për parashtruesin e kërkesës për avancim ose rizgjedhje në pozitën e caktuar.

14. Anëtarët e Komisionit vlerësues mund të zëvendësohen nga organi, i cili i ka deleguar ata sipas paragrafit 4 të këtij neni, nëse konstatohet nga Këshilli Mësimor/Shkencor se Komisioni nuk ka respektuar afatet e parapara në këtë Rregullore, në lidhje me raportin vlerësues.

15. Pas ndryshimit të përbërjes së Komisionit vlerësues, Këshilli Mësimor/Shkencor i jep afat komisionit të ri edhe dhjetë (10) ditë shtesë që të hartojë dhe ta dorëzojë raportin për parashtruesin e kërkesës për avancim.

16. Komisioni vlerësues është i obliguar që gjatë punës së tij të respektojë dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë, Statutin e UShAF, këtë Rregullore, kushtet e avancimit dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

17. Pas hartimit dhe nënshkrimit të raportit nga të pesë (5) anëtarët, kryetari i Komisionit vlerësues, është i obliguar që ta dorëzojë raportin në Këshillin Mësimor/Shkencor.

18. Anëtarët e Komisionit vlerësues mbajnë përgjegjësi ligjore, disiplinore dhe etike për vërtetësinë e të dhënave të shënuara në raportin e vlerësimit, ndërsa për rekomandimet që bëjnë do të sanksionohen sipas kodit të etikës dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.

Neni 13

Procedura pas dorëzimit të raportit nga Komisioni vlerësues

1. Këshilli Mësimor/Shkencor, pas dorëzimit të raportit nga Komisioni vlerësues është i obliguar që në mbledhjen e radhës, jo më vonë se shtatë (7) ditë, të shqyrtojë raportin e Komisionit vlerësues.
2. Këshilli Mësimor/Shkencor është i obliguar që pas shqyrtimit dhe miratimit, ose jo, të raportit të Komisionit vlerësues, vendimin përkatës t'a dorëzojë brenda tri (3) ditëve pranë Administratës së Universitetit.
3. Administrata e Universitetit, nëse konstaton se ka ndonjë lëshim në materialin e dorëzuar nga Këshilli Mësimor/Shkencor, është e obliguar që të informojë Prorektorin për Mësim, Shkencë dhe Çështje studentore dhe të kërkojë nga ai të kompletojë lëndët.

Neni 14

Shqyrtimi i propozimit të Këshillit Mësimor/Shkencor në Senat

1. Në një afat prej tri (3) ditëve pas pranimit të propozimeve të Këshillit Mësimor/Shkencor, Administrata e Universitetit përgatitë për Senat pasqyrën me propozimin për avancim apo rizgjedhje nga Këshilli Mësimor/Shkencor.
2. Vendimi i Senatit rreth propozimit të Këshillit Mësimor/Shkencor për avancim merret më së largu pesë (5) ditë pas përgatitjes së pasqyrës nga Administrata e Universitetit.
3. Nëse Senati vendos ta refuzojë propozimin e Këshillit Mësimor/Shkencor, lënda përkatëse brenda tri (3) ditëve i kthehet për rishqyrtim Këshillit Mësimor/Shkencor.
4. Këshilli Mësimor/Shkencor obligohet që brenda shtatë (7) ditëve, pas pranimit të vendimit të Senatit, të rishqyrtojë lëndën për rivlerësim, dhe vendimin përkatës ta dorëzojë brenda tri (3) ditëve pranë Administratës së Universitetit.
5. Nëse Këshilli Mësimor/Shkencor, edhe pas rishqyrtimit sjell të njëjtin propozim, Senati në një afat jo më të gjatë se shtatë (7) ditë nga pranimi i propozimit, merr vendim përfundimtar.

Neni 15

Vendimi dhe periudha e ankimimit

1. Procedura e votimit në Senat për propozimin e Këshillit Mësimor/Shkencor, rreth avancimit të personelit akademik, bëhet sipas Rregullores së Punës të Senatit.
2. Ndaj vendimit të Senatit në afat jo më larg se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas pranimit në dorëzim të vendimit, mund të bëhet ankesë në Komisionin e Senatit për Ankesa dhe Parashtresa, që shërben si instancë e parë dhe e fundit e ankimimit në UShAF.



Neni 16

Dispozitat kalimtare


1. Për avancim dhe rizgjedhje, deri më datë 31.12.2023, do të vlejnjë të gjitha punimet shkencore të publikuara si autor i parë në të gjitha databazat e precizuara nga Rregullorja paraprake numër 2641/19, të datës 01.08.2019.
2. Për rizgjedhje ose avancim, nga data 01.01.2024, do të merren parasysh vetëm punimet shkencore të publikuara në revista ndërkombëtare dhe të indeksuara në platformat vijuese: Web of Science (SCIE, SSCI apo AHCI) dhe Scopus (Elsevier).
3. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje do të pranohen për rizgjedhje ose avancim vetëm punimet shkencore që do të publikohen në databazat e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni. Përrjashtimisht, punimet e personelit akademik që paraprakisht janë dorëzuar për shqyrtim në revista ndërkombëtare para miratimit të kësaj Rregulloreje (sipas rregullores paraprake numër 2641/19 të datës 01.08.2019) do të pranohen për avancim të stafit akademik vetëm nëse publikohen para datës 15 Shtator 2022. Instancat përkatëse në fakultet dhe rektorat rezervojnë të drejtën për verifikim dhe ofrimin e dëshmive nëse punimet e tilla janë dorëzuar për vlerësim para hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.
4. Në pamundësi për të plotësuar kushtet e reja ligjore të dala në Statutin e ri të UShAF-it, personelit akademik që u skadon kontrata u mundësohet vazhdimi automatik i kontratës për një periudhë kohore më së shumti 1 vjeçare. Vendimin për këtë e merr Senati sipas propozimit të Këshillit të Mesimor/Shkencore.

Neni 17

Dispozitat përfundimtare

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja paraprake numër 2641/19, e datës 01.08.2019.
2. Kjo Rregullore hyn në fuqi nga dita e miratimit në Senatin e UShAF.

Kryesues i Senatit të UShAF,
Prof/Dr. Agron BAJRAKTARI, Rektor



Shtojca I

FORMULAR PËR AKTIVITETIN ARSIMOR (MËSIMDHËNIE) DHE PROFESIONAL

Tabela I.1 Aktivitetet mësimore

Institucioni	Lënda/ët e ligjëruar/a	Periudha		Niveli i studimeve (Bachelor/Master)
		Prej	Deri	

Tabela I.2 Mentorimi

Emri i parashtruesit	Institucioni	Diploma / Niveli i studimit (Bachelor/Master/Doktoraturë) ²	Data e përfundimit

²Punimi i diplomës në studimet 5 ose 6 vjeçare, lidhur me avancimin ose rizgjedhjen e personelit akademik, konsiderohet ekuivalent me punimin e nivelit Master.

-1/2

Tabela I.3 Pjesëmarrja nga kongreset, konferencat, simpoziumet, seminarët dhe punëtoritë

Nr	Konferenca/Kongrese/...	Vendi	Viti	Prezantim/Pjesëmarrje

Tabela I.4 Pjesëmarrja në trajnime profesionale

Nr	Lloji i trajnimit	Vendi	Viti	Organizatori

Tabela I.5 Përvoja profesionale (jo-akademike)

Institucioni	Pozita	Periudha		Shënime të tjera
		Prej	Deri	

Sp.

Tabela I.6 Publikimet e monografive, librave, kapitujve të librave, dispensave, etj.

Nr	Autorët (renditja si në punim)	Titulli i publikimit	Lloji i publikimit	Shtëpia botuese	Viti

Tabela I.7 Anëtarësimi në organizata/ institucione profesionale

Nr	Organizata/Institucioni	Lloji i anëtarësisë	Viti i anëtarësimit	Shtëpia botuese	Viti

afp.

Tabela I.8 Pjesëmarrja në komisione redaktuese të botimeve universitare, revistave shkencore, konferencave, etj.

Nr	Libri/Publikimi	Autori/redaktori përgjegjës	Viti

Tabela I.9 Recensent në botime universitare

Nr	Libri	Autori	Shtëpia botuese	Viti

ff.

Shtojca II

FORMULAR PËR AKTIVITETIN HULUMTUES, SHKENCOR DHE PROFESIONAL

A. Publikimet në revista shkencore ndërkombëtare dhe aktivitete artistike

Tabela I.1 Publikimet në revista shkencore ndërkombëtare

Nr	Autorët (renditja si në punim)	Titulli i punimit	Revista	Vëllimi, nr., faqet, viti	Linku identifikues	Impakt faktori

Tabela I.2 Aktivitetet artistike

Nr	Autorët (renditja si në punim)	Titulli i aktivitetit	Lloji i ngjarjes	Karakter	Linku identifikues

Sp.

B. Publikimet në revista akademike ose shkencore, ndërkombëtare ose vendore që nuk janë përfshirë në tabelën A.1 (në cilësinë e autorit të parë ose bashkautorit)

Tabela II.1 Publikimet në revista akademike ose shkencore ndërkombëtare

Nr	Autorët (renditja si në punim)	Titulli i punimit	Revista	Vëllimi, nr., faqet, viti

Tabela II.2 Aktivitetet tjera artistike

Nr	Autorët (renditja si në punim)	Titulli i punimit	Revista	Vëllimi, nr., faqet, viti

A.P.

Tabela II.3 Publikimet në revista akademike ose shkencore vendore

Nr	Autorët (renditja si në punim)	Titulli i punimit	Revista	Vëllimi, nr., faqet, viti

C. Aktiviteti tjetër kërkimor - shkencor

Tabela II.4 Kontribute tjera shkencore dhe profesionale

Nr	Autorët (renditja si në kontributin shkencor)	Lloji i kontributit shkencor	Viti, Vendi

f.p.

D. Kontributi në projekte të kërkimeve themelore dhe të aplikueshme

Tabela II.5 Pjesëmarrja e dëshmuar në programe ose projekte të kërkimeve themelore dhe të aplikueshme

N r	Programi/ projekti shkencor	Periudha kohore	Institucioni/ Vendi	Pozita në program, projekt/ Kontributi

E. Patente në nivel ndërkombëtar ose kombëtar

Tabela II.6 Patentet zyrtare në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar

N r	Autorët (renditja si në patentin e zyrtarizuar)	Titulli i patentit	Institucioni/ Vendi, Viti i zyrtarizimit	Faqet

ff.

Shtojca III

FORMULAR PËR AKTIVITETIN SHËRBYES

Kjo shtojcë përfshinë aktivitetin në shërbim të Universitetit, Fakultetit dhe Komunitetit nëpërmjet shërbimit specifik përkatësisht pjesëmarrjes në komitete/komisione akademike, administrative ose ekipe profesionale.

Tabela III.1 Shërbimi në lidhje me Universitetin

Shërbimi, përkatësisht pozita në komitet/komision/ekip	Kohëzgjatja	Përshkrim i shkurtë rreth shërbimit

Tabela III.2 Shërbimi në lidhje me Universitetin

Shërbimi, përkatësisht pozita në komitet/komision/ekip	Kohëzgjatja	Përshkrim i shkurtë rreth shërbimit

Tabela III.3 Shërbimi në lidhje me Komunitetin

Shërbimi, përkatësisht pozita në komitet/komision/ekip	Kohëzgjatja	Përshkrim i shkurtë rreth shërbimit

f.b.